

AUTORITETI I KOMUNIKIMEVE ELEKTRONIKE DHE POSTARE
DREJTORIA E TREGJEVE DHE MASAVE RREGULLATORE

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më ____ . ____ . 2020

Lënda: Kthim Përgjigje

Qendra “Konsumatori Shqiptar”
Durrës

Të nderuar,

Në emër të AKEP ju përgëzojmë për punën dhe veprimtarinë e cila i vjen në mbështetje të mbrojtjes së konsumatorit.

AKEP është organi rregullator në fushën e komunikimeve elektronike dhe postare dhe kompetencat e tij janë të përcaktuara në ligjin Nr.9918, datë 19.5.2008 (i ndryshuar) “Për Komunikimet Elektronike në Republikën e Shqipërisë” (ligji). Ju sjellim në vëmendje se, sipas këtij ligji, tregu i shërbimeve celulare me pakicë nuk përfshihet në listën e tregjeve të rregulluara nga AKEP.

Ndonëse në kushtet e mos-kompetencës për të ndërhyrë në rregullimin e këtij tregu, AKEP po vijon monitorimin e situatës dhe është në proces konsultimi, orientimi me sipërmarrësit/operatorët dhe autoritetet ligjzbatuese, për sa i përket trajtimit sa më të drejtë të kërkesave/ankesave të komsumatorëve/pajtimtarëve.

Theksojmë se AKEP është angazhuar maksimalisht që nga momenti i njoftimit të ndryshimit të tarifave për zbatimin e legjislacionit në fuqi për konkurrencën e lirë dhe të ndershme me qëllim që konsumatori të përfitoj një shërbim sa më cilësor e transparent.

Lidhur me pyetjet e adresuara për AKEP, lutem gjeni përgjigjet si më poshtë:

1. Sipërmarrësit e komunikimeve elektronike, Albtelecom sh.a, Telekom Albania sh.a dhe Vodafone Albania sh.a, sipas detyrimit ligjor të përcaktuar në nenin 8 të Rregullores së AKEP, Nr.27, datë 21.09.2012, e ndryshuar, “*Mbi Publikimin e informacionit për tarifat si dhe kushtet e aksesit dhe përdorimit të shërbimeve të komunikimeve elektronike publike*”, kanë njoftuar në AKEP se do të nxjerrin në treg paketa standarde mujore të reja për përdoruesit me parapagesë, përkatësisht në datat 30.1.2020, 5.2.2020 dhe 11.2.2020.

Lidhur me detyrimet e parashikuara në ligjin nr. 9902/2008 “Për mbrojtjen e konsumatorëve”, ju ftojme t’i adresoheni Komisionit të Mbrojtjes Konsumatore pranë Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë.

2. AKEP, duke marrë parasysh shqetësimin e shprehur nga pajtimtarët lidhur me ndryshimin e tarifave u ka kërkuar sipërmarrësve informacion shtesë mbi arsyen e rritjes së çmimeve të paketave të reja standarde mujore.

Sipërmarrësit kanë argumentuar se rritja e çmimeve të këtyre paketave ka të bëjë kryesisht me faktin e rritjes mesatare të përdorimit të njësive të komunikimit, veçanërisht njësitë e internetit (*Data*), dhe kostot shtesë që po përballojnë sipërmarrësit në implementimin e pajisjeve dhe aparaturave të reja për teknologjinë 4G me qëllim përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë së këtij shërbimi.

3. Referuar ligjit për komunikimet elektronike si dhe praktikave më të mira të rregullatorëve të vendeve të Bashkimit Evropian, tregu i shërbimeve celulare me pakicë nuk përfshihet në listën e tregjeve të rregulluara nga organet rregullatore, e rrjedhimisht nga AKEP.

Për sa më sipër, lutem drejtojuni Autoritetit të Konkurrencës, si institucioni kompetent për trajtimin e kësaj pyetjeje, pasi ky institucion monitoron kushtet e sjellës së ndërmarrjeve në treg, kryesisht marrëveshjeve të ndaluara, neni 4 dhe abuzimi me pozitën dominuese, neni 9 i Ligjit nr. 9121 “Për mbrojtjen e konkurrencës”.

4. Sipas nenit 8 të Rregullores së AKEP, Nr.27, datë 21.09.2012, e ndryshuar, “*Mbi Publikimin e informacionit për tarifën si dhe kushtet e aksesit dhe përdorimit të shërbimeve të komunikimeve elektronike publike*”, sipërmarrësit e shërbimeve publike të komunikimeve elektronike janë të detyruar të njoftojnë, nëpërmjet mjeteve të informimit publik, çdo ndryshim në tarifën e shërbimeve, jo më pak se 7 ditë përpara hyrjes në fuqi të tyre ose të ndryshimeve dhe ky njoftim duhet të bëhet jo më pak se 3 ditë rresht.

Konkretisht, sipërmarrësit kanë njoftuar nëpërmjet mjeteve të informimit publik/gazeta, për 3 ditë radhazi si më poshtë:

Albtelecom sh.a ka njoftuar nëpërmjet:

- 1- Gazetës Dita, Panorama, Shqiptare në datat 27-28-29 dhjetor 2019
- 2- <https://www.albtelecom.al/al/individuale/mobile/me-parapagese/paketat-super/>

Telekom Albania sh.a ka njoftuar nëpërmjet:

- 1- Gazetës Shqiptare, Standard, Koha Jonë në datat 06-07-08 janar 2020
- 2- <https://www.telekom.com.al/category/paketa-standarde/cat7330485/>

Vodafone Albania sha.a ka njoftuar nëpërmjet:

- 1- Gazetës Shqiptare, Dita, Tema, Mapo, Telegraf, Koha Jonë në datat 04-05-06 shkurt 2020
- 2- <https://www.vodafone.al/eshop/te-gjiitha-paketat/paketa-30-ditore/c-120009/>

Gjithashtu, për tu ardhur në ndihmë pajtimtarëve AKEP përmes website-it zyrtar informon dhe publikon të dhëna krahasuese mes tarifave që ofrojnë të tre sipërmarrësit.

Për më tepër linku si më poshtë:

<https://akep.al/wp-content/uploads/2018/11/TARIFAT-E-SHERBIMIT-NGA-RRJETE-CELULARE-NE-SHOIPERI-1.pdf>

5. Referuar pikës 5, 6 dhe 7, sikurse u përmend edhe me sipër , tregu i shërbimeve celulare me pakicë nuk përfshihet në listën e tregjeve të rregulluara nga AKEP. Gjithsesi, AKEP pasi ka analizuar informacionin e marrë nga operatorët lidhur me tarifat e paketave të reja mujore, bazuar edhe në detyrimet ligjore të përcaktuara në ligjin 9918/2008, e ka adresuar çështjen për trajtim dhe kompetencë në Autoritetin e Konkurrencës.

Duke ju falenderuar, me konsideratë,